



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 32.

Prishtinë, më 10.12.2015 në orën 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj- Gutaj, Vjosa Osmani, Arben Gashi dhe Kujtim Paçaku .

Munguan: Rustem Mustafa, Ilir Deda, Valdete Bajrami, Slobodan Petroviq dhe Time Kadrijaj.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky :

Rend i Ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen .

1. Miratimi i Rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i projektligjit nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamentet e Komisionit Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor të projektligjit dhe theksoi se ky Projektligji përmban 20 nene dhe 62 amendamente të Komisionit Funksional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian, sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin e shteteve anëtare, nuk janë të rregulluar me legjislacionin e BE-së, por mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare. Ndërsa buxheti i Bashkimit Evropian është çështje e cila rregullohet nga institucionet e saj sipas ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësisë në kuadër të Bashkimit Evropian.

Dhe në fund, pas shqyrtimit dhe vlerësimit, konstatohet se Projektligji Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së, përkatësisht të Acquis Communitare të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend, tha Teuta Sahatqija dhe e hapi debatin.

Kujtim Paçaku lidhur me neni 10, që ka të bëjë për shfrytëzimin e mjeteve për komunitete Buxheti i ndarë për Zyrën për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, kategoria subvencione dhe transfere dhe buxheti i ndarë për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, për projektet kapitale, tha se Grupi parlamentar 6+ , ka bërë një amendament me të cilin kemi menduar ti fusim në linjën buxhetore edhe Zyrat për komunitete në ministritë tjera, si në Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Bujqësisë, MASHT-in dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Arben Gashi theksoi se është dashtë që këtë amendament me e dërgua në Komisionin për Buxhet dhe Financa ose si grup parlamentar ose si deputet individualisht dhe nëse do të vinte nga komisioni për buxhet, me apo pa përkrahjen e komisionit, ne do të mundnim ta shqyrtonim sepse duke pas parasysh që ne i shqyrtojmë projektligjet vetëm nga aspekti i përputhshmërisë me Acquis Communitare, tani nuk është në fushëveprimtarinë tonë të diskutojmë për këtë çështje.

Teuta Sahatqija, kryetare –Ju e dini se në Komision i shqyrtojmë nenet dhe amendamentet për të cilat mendoni se nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe atëherë ne mund të japim mendim, kurse sa i përket amendamentimit të ri, së pari duhet të shqyrtohen në Komisionin Funksional.

Kërkesën tuaj z.Paçaku, mund ta paraqitni edhe në seancën plenare si instancë më e lartë.

Kujtim Paçaku, theksoi se edhe në leximin e parë i ka kundërshtuar linjat buxhetore, Ministria për Komunitete dhe Kthim, me kodin organizativ: Projekti i Konsoliduar për të Kthyerit, sepse komuniteti rom ka më së shumti të riatdhesuar kurse janë nda më pak mjete se komunitetet tjera që kanë shumë më pak të kthyer.

Vjosa Osmani në diskutimin e saj i dha dy arsye përse do të abstenojë me rastin e votimit të buxhetit.

E para, tha ka të bëjë me Ligjin për skemën pensionale. Para 3 vitesh ky ligj është kthyer disa herë mbrapsht në Komisionin FunkSIONAL, atëherë për shkak se ky komision nuk pranonte të përfshihej një dispozitë e cila e njihte përvojën e punës të kategorive të ndryshme, qoftë arsimit, shëndetësisë dhe të tjerët, të cilët kanë punuar gjatë viteve të 90-ta, rrjedhimisht kështu shkeleshin edhe një numër i madh i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e Acquis, të cilat dhënie e pensione e kanë bërë në bazë të parimit të kontributdhënësit, që gjithmonë është interpretuar duke pasqyruar gjithë përvojën e punës.

Pas shumë përpjekjeve ky komision pati arritur ta kalojë këtë amendament njëzëri, që të bëhet pjesë e ligjit për skemat pensionale, por çka ka ndodhur, në buxhetin e vitit të kaluar, kemi bërë edhe një amendament në pjesën tabelore, i cili ka kaluar në seancë, por gjatë tërë vitit qytetarëve të cilët kanë pas përvojë pune në vitet e 90-ta, nuk iu është njohur ajo përvojë, e ju e dini se lartësia e pensionit caktohet në bazë të viteve të përvojës së punës dhe shumë prej tyre kanë marrë pensione më të vogla sepse ato vite nuk iu janë llogaritur.

Arsyeja e dytë, që nuk lidhet drejtpërdrejt me Acquis komunitare, por tha se duhet ta përmend, sepse ne duhet të japim shembuj duke i pa disa prej modeleve më të mira të shteteve të Evropës, që buxhetin e shëndetësisë e kanë prej prioritetëve kryesore.

Me amendamentet që janë bërë, ka shkurtime të mëdha në buxhetin e shëndetësisë, duke përfshirë amendamentin 20, që për mua është brenga kryesore.

Kryetarja pas diskutimeve konstatoi se komisioni me një abstenim nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së, përkatësisht të Acquis Komunitare të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Teuta Sahatqija, kryetare, prezantoi opinionin ligjor të këtij Projektligji, duke thënë se projektligji përmban 11 nene dhe 5 amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe çështjet e adresuara në këtë Projektligj, nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, andaj konstatohet se projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të miratohet dhe rekomandohet për procedurë të rregullt në Kuvend.

Vjosa Osmani ngrii një çështje që e vlerësoi si më shumë si procedurale, duke thënë se ky projektligj ka ardhë prej Ministrisë së Financave si propozim, në të njëjtën kohë në Kuvend ka muaj të tërë që kemi një projektligj tjetër për menaxhimin e financave publike që është iniciuar nga 14 mijë qytetarë, një ndryshim ku propozohet që qytetarëve të Kosovës, të cilëve u shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me kushtetutë nga ana e institucioneve publike, përveç dëmit material, t'u kompensohet edhe dëmi jo material, sepse deri më tani ka qenë ky ligj i cili ua ka ndaluar një gjë të tillë dhe fillimisht ka qenë në kundërshtim, jo vetëm me Kushtetutën e Kosovës, me Kodin Penal dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me të drejtën civile, por edhe me parimet themelore të Acquis komunitare dhe ndër arsyetimet kryesore pse edhe është propozua ai ndryshim, pikërisht ka qenë kjo.

Më duket anomali se në Kuvend i kemi dy projektligje për plotësimin dhe ndryshimin për menaxhimin e financave publike. Nëse ky projektligji kalohet vetëm me propozimet nga Ministria e Financave, vazhdon me qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Acquis Communitare sepse vazhdon t'ua parandalojë qytetarëve të Kosovës kompensimet e dëmit jo material. Andaj për këtë Projektligj do të votoj kundër.

Kryetarja pas diskutimeve, konstatoi se komisioni me një votë kundër nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Shqyrtimi i projektligjit nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Teuta Sahatqija, kryetare, tha se ky projektligj përmban 70 nene dhe 21 amendamente të Komisionit Funksional dhe prezantoi opinionin ligjor, duke thënë se Projektligji, së bashku me amendamente është shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha e cila mbulon këtë Projektligj, nuk është kundërshtim me parimet e BE-së, përkatësisht Acquis Communitare dhe mund të rekomandohet për miratim.

Vjosa Osmani tha se në ligjin e kaluar që e kemi miratuar në fund të mandatit të kaluar, ka qenë një nen, me të cilin ju jepej përparësi kompanive vendore për një periudhë të caktuar dhe kur kemi diskutuar, ideja ka qenë që ai nen të vlejë deri në hyrje në fuqi të MSA-së. Mirëpo, tani MSA e ka një dispozitë që jep një afat të caktuar prej dy vitesh, që lejon një përparësië tillë ndaj kompanive vendore të vazhdohet, dhe pyeti stafin se a vazhdon të jetë apo është fshi, nëse është fshi, pse? Pasi MSA-ja lejon edhe për dy vite të tjera, kërkoj të përgjigjet dikush nëse e din.

Arben Gashi tha se Ligji për ratifikimin e MSA-së është një ligj i veçantë që rregullon fusha specifike. Për këtë arsye detyrimet dhe obligimet që dalin prej atij ligji janë drejtpërdrejt të zbatueshme sepse është ligj i rëndësisë së veçantë, i ratifikuar me 2/3 dhe dispozitat e atij ligji që rregullohen me afate kohore prej dy vitesh vlejné edhe për çështjet e prokurimit publik, do të duhej edhe një interpretim prej ministrisë së integriteteve dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Vjosa Osmani tha se ka pjesë të caktuara të MSA-së, që në mënyrë specifike kërkojnë nxjerrje të ligjeve dhe nëse e shihni Planin e Veprimet për implementimin e MSA-së, kërkohet nxjerrja e ligjeve të reja, e kjo nënkupton që institucionet e Kosovës nuk e marrin si drejtpërdrejt të zbatueshme, prandaj edhe nëse MSA-ja e lejon hapësirën prej dy vjetësh që të vazhdohet me atë beneficion për kompanitë vendore dhe kjo është fshi tani, dhe nuk po e shoh të nevojshme se ka mundësi që pas dy vitesh të ndryshohet ky ligj, sepse e dini se shumë shpesh ndërrohet.

Kryetarja pas diskutimeve konstatoi se Komisioni me një votë kundër nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Të ndryshme.

Kryetarja në këtë pikë kërkoi të diskutohet për Draft rezolutën për Kosovën, të prezantuar nga raportuesja Ulrike Lunaček, nëse ka dikush ndonjë koment, vërejtje apo propozim.

Pika 4, tha ajo, flet për fuqizimin e rolit të Kuvendit dhe Komisionit për Integritet Evropian. Andaj kryetarja propozoi që të lëshohet një komunikatë, ku është përkrah fuqizimi i Komisionit tonë dhe përkrahet çdo amendament i bërë për Kuvendin. Ne do ti japim përkrahje të plotë Projektrezolutës dhe inkurajojmë ta miratojë Parlamenti Evropian .

Vjosa Osmani tha se nëse lëshohet komunikatë nga takimi i sotëm, përveç mbështetjes së Rezolutës, të ndalemi te pika 4, ku është përkrahur fuqizimi i rolit të Komisionit për Integritet Evropian nëpërmes legjislacionit të ri, që do të miratohet për Kuvendin. Kjo do të thotë se po përkrahet çdo amendament që ne e kemi bërë në ligjin për Kuvendin, përfshirë fuqizimin e Komisionit.

Kryetarja tha se duhet të shtohet në deklaratë edhe inkurajimi për pesë shtete, liberalizimi i vizave dhe dialogun mes partive politike .

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Teuta Sahatqija